



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 96220 datë 06.08.2026 së Këshillit Organizativë i turneut tradicional “Reçani 2026”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet pjesërisht kërkesa 01-030 nr. 96220 datë 06.08.2026 e Këshillit Organizativë, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth organizimit të turneut tradicional “Reçani 2026”, që mbahet çdo vit në fshatin Reçanë në Zhup, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve përkatëse (përgatitja e terrenit sportiv, blerje të pajisjeve sportive, pajisjeve mjekësore, dhuratave dhe shpenzime tjera), lejohen mjetet financiare në shumën prej 1000 € (njëmijë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Këshillit Organizativë të Turneut në Reçanë,
 - Arkivës së Kryetarit.